



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2622 prot

Himarë, më 30.05.2022

VENDIM

Nr. 34, datë 27.05.2022

**PËR SHPREHJEN E PELQIMIT NË PARIM PËR DHËNIEN ME QIRA SHOQËRISË
"KALLTUN ATLANTIC ENERGY" shpk, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 10000M², NË
NGASTRËN NR.7, EKONOMIA PYJORE "GJOMOLL"**

Bazuar në ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin 57/2020 "Për pyjet", neni, 11, pika b) "Mbarështimi i pyjeve", ligjin nr.9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyjor e kullësor publik....."

Këshilli Bashkiak Himarë pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë miratoi me 14 vota pro, 0 kundra, 0 abstenim dhe si më poshtë ...

VENDOSI

1. Të shprehë pëlqimin në parim për dhënie me qira shoqërisë "KALLTUN ATLANTIC ENERGY" shpk, të një sipërfaqeje prej 10000m² në ngastrën nr.7, ekonomia pyjore "Gjomoll".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55, pika 6.



KRYETAR
DHIMITËR KAPAJ